



RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 01/22 Nr. i faq./Br.str./No.pg 33
Data/Datum/Date 28.02.2023

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019"), nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 2, nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2023 merr këtë:

V E N D I M

Për këmbimin e pronës komunale me pronën private

1. Miratohet vendimi dhe jepet PËLQIMI për këmbimin e pronës publike komunale me pronën private për interes publik, e cila gjendet në vendin e quajtur Skeja, zona kadastrale Xërxë, ngastra me numër P-71510033-01038-2 sipas Certifikatës së pronësisë pronë e Komuna e Rahovecit, me sipërfaqe të përgjithshme prej 1231m² (njëmijë e dyqind e tridhjetë e një metra katror) I JEPET në posedim Isni (Vehbi) Thaqi nga fsh. Xërxë, Komuna e Rahovecit, ndërsa ngastra sipas Certifikatës së pronësisë P-71510033-01041-1 në posedim të Isni (Vehbi) Thaqi nga fsh. Xërxë me sipërfaqe të përgjithshme prej 1472m² (njëmijë e katërqind e shtatëdhjetë e dy metra katror) I JEPET Komunës së Rahovecit, në emër të këmbimit për hapjen e rrugës publike.
2. Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme komunale me pronën private të cekur në pikën 1 të këtij vendimi është për interes publik, dhe se në të njëjtin vend nuk ekzistojnë parcela tjera komunale të përshtatshme për këtë qëllim.
3. OBLIGOHET, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që ti zhvilloj procedurat ligjore në përputhje me dispozitat e nenit 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
4. Vlerësimi i pronës komunale dhe pronës private të cekur në pikën 1 të këtij vendimi bëhet në bazë të ligjit përkatës për pronën e paluajtshme.

5. Pas përfundimit të procedurave për këmbim, rezultatet e këmbimit duhet publikuar, me përmbajtjen e të dhënave të pronave të këmbjës, si dhe emrin e pronarit privat me të cilin është bërë këmbimi.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Kuvendit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.33/2023
Me datë:28.02.2023

